



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

22 dhjetor 2011

Legjislatura IV-të

Aktiviteti legjislativ i Kuvendit gjatë vitit 2011
(shkurt -dhjetor 2011)

I. Konstituimi i Kuvendit dhe zgjedhja e organeve dhe trupave punues

- Legjislatura e IV-të, është konstituuar më 21 shkurt 2011
- Zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit, 21 shkurt 2011
- Presidenti është zgjedhur më 22 shkurt 2011
- Qeveria është zgjedhur më 22 shkurt 2011
- Komisionet(13 komisione) janë formuar më 10 mars 2011
- Presidentja është zgjedhur më 7 prill 2011
- Komisioni për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është formuar më 22 prill 2011
- Komisioni për amendamentimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, është formuar më 22 prill 2011

II. Aktivitetet e Kryesisë së Kuvendit

Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka mbajtur **44** mbledhje, ka miratuar **121** vendime dhe **67** përfundime.

III. Seancat plenare të Kuvendit

Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka mbajtur 44 mbledhje plenare, prej tyre dy (2) të jashtëzakonshme dhe tri (3) solemne. Kuvendi ka miratuar 276 Vendime (miratim ne parim,

miratim ne lexim te dytë të ligjeve, mocioneve, vendime për emërime të bordeve, këshillave, komisione dhe te agjencive te pavarura).

IV. Aktivitetet e komisioneve parlamentare

Mbledhje të mbajtura	460
Mbledhje të Kryetarit të Kuvendit me kryetarët e Komisioneve parlamentare	6
Projektligje të shqyrtuara dhe amendamentuara	65
Projektligje të kthyer për ripunim	2
Numri i takimeve të grupeve punuese	297
Monitorimi i zbatimit të ligjeve	11
Shqyrtimi i raporteve vjetore të agjencive të pavarura dhe raportet e audituara	80
Vizitat jashtë vendit	31
Vizitat brenda vendit	96
Dëgjime publike	68

V. Aktiviteti ligjvënës i Kuvendit

Projektligje të proceduara-----	94
Ligje të miratuara-----	65
Projektligje në procedurën e shqyrtimit në komisione parlamentare-----	27
Projektligje të pa miratuara-të kthyer për ripunim Qeverisë-----	2
Qeveria e Kosovës, është dashur t'i procedojë në Kuvend-----	143 P/L
Projektligje të pa proceduara, sipas afatit të paraparë-----	49

VI. Aktiviteti i mbikëqyrës i Kuvendit në zbatimin e ligjeve

1	Ligji për duhanin
2	Ligji për Minierat dhe Minerale
3	Ligji për financat e pushtetit lokal
4	Ligji për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës
5	Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës
6	Ligji për qasje në dokumente publike
7	Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje
8	Ligji për Ripranim
9	Ligji për tokën bujqësore

10	Ligji për liritë fetare në Kosovë
11	Ligji për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar

VII. Interpelancat

1	Interpelancë më Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi , tme kërkesë të Grupi Parlamentar i të Lëvizjes Vetëvendosje, për Bisedimet Kosovë-Serbi,
2	Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, lidhur me autostradën Morinë - Merdarë.
3	Interpelancë me Kryeministrin e Qeverisë të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, lidhur me situatën politike dhe të sigurisë në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje
4	Interpelancë me ministren e Tregtisë dhe industrisë, znj. Mimoza Kusari- Lila, lidhur me masat e reciprocitetit me Serbinë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje.

VIII. Pyetjet parlamentare

Gjatë periudhës mars - dhjetor 2011, janë parashutuar 124 pyetje parlamentare, prej tyre 106 kanë marr përgjigje, ndërsa 18 janë publikuar në Revistën e Kuvendit.

IX. Rezoluta, Deklarata dhe Rekomandime

1	Rezoluta për dialogun ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë(më propozim të GP të PDK-së)
2	Rezoluta për mbështetje të Memorandimit të Marrëveshjes në mes të z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi, të nënshkruar me 6 prill 2011(më propozim të GP të PDK-së, LDK-së dhe KKR-së)
3	Rezoluta për angazhimin e Kosovës drejt integritit në Bashkimin Evropian më propozim të Komisionit për Integritime Evropiane
4	Rekomandimet lidhur me gjendjen e sigurisë dhe sundimin e ligjit në Kosovë (më propozim të deputetit Nait Hasani dhe grupi i deputetëve)
5	Rekomandimet lidhur me masakrën në burgun e Dubravës, 19 – 25 maj 1999, gjatë luftës në Kosovë(më propozim të deputetit Nait Hasani dhe grupi i deputetëve)
6	Rekomandime për bashkëpunimin e Republikës së Kosovës me Interpolin dhe Europolin, lidhur me rastet të ngritura nga Republika e Serbisë pranë këtyre institucioneve, për disa qytetarë dhe zyrtarë të lartë shtetëror të Republikës së Kosovës(më propozim të deputetit Ramiz Lladrovci dhe Grupi i deputetëve)
7	Rekomandime për përsheptimin e procesit gjyqësor nga Tribunali i Hagesë për rigjykimin e pjesshëm të Ramush Haradinajt dhe ofrimi i ndihmës juridike dhe financiare nga Qeveria
8	Debat parlamentar lidhur me dialogun e Qeverisë të Republikës së Kosovës me Republikën e Serbisë dhe marrëveshjet e arritura në këtë dialog, sipas kërkesës së GP LDK, GP LVV dhe GP AAK.
9	Rezolutë për mbështetje të institucioneve në ushtrimin e kontrollit të plotë në tërë territorin e Republikës së Kosovës

10	Debat parlamentar lidhur me Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, për vitin 2011, sipas kërkesës së GP LDK
-----------	---

X. Programi dhe Planet e veprimit

- Programi i Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2011, është miratuar më 22 prill 2011,
- Plani i veprimit të Kuvendit për integritime evropiane, për vitin 2011, është miratuar më 28 prill 2011,
- Miratimi i Raportit të dytë për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritime evropiane, për vitin 2011, 21 dhjetor 2011,
- Raporti i Parë i Progresit për Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritim Evropian për vitin 2011, 23 gusht 2011,
- Miratimi i Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritime evropiane, për vitin 2012, 21 dhjetor 2011.

XI. Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare

- Ratifikimi i Marrëveshjes për financim dhe grante ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore, ratifikuar më 6 maj 2011,
- Ratifikimi i Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UNCTAD, për projektin softueri për dogana, ratifikuar më 6 maj 2011,
- Ratifikimi i Marrëveshjes për financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe Shoqatës ndërkombëtare për zhvillim, ratifikuar më 6 maj 2011,
- Ratifikimi i Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Republikës së Kosovës dhe KfW- Frankfurt am Main dhe Kompanisë së Ujësllësit Regjional-Prishtina, ratifikuar më 6 maj 2011,
- Ratifikimi i Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës të Madh të Luksemburgut, ratifikuar më 6 maj 2011,
- Ratifikimi i Marrëveshjes për financimin e projektit për modernizimin e sektorit publik në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe Shoqatës ndërkombëtare për zhvillim, ratifikuar më 6 maj 2011,
- Ratifikimi i Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor, 16 qershor 2011,
- Ratifikim i Marrëveshjes për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturën e tregut në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, 11 nëntor 2011,
- Ratifikim i Marrëveshjes për financimin e Projektit për bujqësi dhe zhvillim rural në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, 11 nëntor 2011.

XII. Aktet e tjera

- Rregullorja për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit, miratuar më 19 maj 2011,
- Raporti financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës, miratuar më 19 maj 2011,
- Miratimi i Planit Hapësinor i Republikës së Kosovës, për periudhën 2011-2020, 16 qershor 2011,
- Miratimi i Planit Kombëtar i shpërndarjes së spektrit radiofrekuencor, 23 qershor 2011,
- Miratimi i Buxhetit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për periudhën 23 qershor – 31 dhjetor 2011, 22 shtator 2011,
- Miratimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me përcaktimin e përgjegjësiave dhe procedurave të dërgimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit, 7 tetor 2011,
- Miratimi i Planit Hapësinor 2010-2020 - Zona me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re, 7 tetor 2011,
- Miratimi i Strategjisë dhe Planin e Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020, 7 tetor 2011
- Miratimi i Propozimit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese, nga 0.65% në 0.60%, 14 nëntor 2011.